



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 89 /2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, gjyqtarët Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e për apelin e Centar Demokratske Unije (CDU), në Prizren , paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos emërimit të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit, në seancën e panelit të mbajtur me 03.06.2014 mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET si i pas afatshëm apeli i Subjektit Politik Centar Demokratske Unije (CDU), në Prizren.**

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datën 30.05.2014 ka pranuar një apel, nga Centar Demokratske Unije (CDU), në Prizren në të cilin thekson se në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, partitë të cilat i kanë këshillatet në komunën e Prizrenit do të duhej ta kenë edhe të drejtën për ti pasur anëtarët e komisioneve në këtë komunë.

Kjo e drejtë sipas parashtruesit të apelit iu është mohuar dhe me këtë është duke u shkelur ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kërkojnë që të ju kthehen anëtarët e komisioneve nëpër vendet ku jetojnë boshnjaket, në aq numër sa ju takon. Gjithsejtë janë 25 anëtarët e komisioneve që i kanë dorëzuar sipas kërkesës së komisionit komunal. Insistojmë që kjo ankesë të pranohet.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 30.05.2014, për apelin që është bërë ndaj saj nga ana e CDU-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj këtij apeli deri më datë 31.05.2014 në ora 10:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ, në të cilën theksohet se me Vendimin 1027 të datës 27.05.2014, KQZ ka emëruar Këshillat e Vendvotimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 8 qershorit.

Me dispozitat e LZP-së neni 63.6 shprehimisht është përcaktuar "Vendimi i KQZ nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj".

Ndërsa, me dispozitat e nenit 122 të LZP-së janë konkretizuar rastet në të cilat personat fizik dhe juridik kanë të drejtë ti apelojnë Vendimet e KQZ-së në PZAP.

**PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e apelit gjeti se :**

**Apeli është i pasafatshëm .**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se apeli i parashtruar është jashtë afatit ligjor sepse afati ligjor sipas LZP-së, është 24 orë nga momenti i pranimit të vendimit me të cilën KQZ-ja me vendimin Nr. 1027 të datës 27.05. 2014 ka emëruar Këshillat e Vendotimeve për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 8 qershor 2014, ndërsa pala apelin e ka parashtruar në PZAP, më datë 31.05.2014. Andaj nga kjo del se apeli në fjalë është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor në LZP. Prandaj duke u bazuar në Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it nenin 4.2. dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, apeli vlerësohet si i pasafatshëm, lidhur me apelin e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi .

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 89 /2014 më datën 03. 06.2014.



*Udhëzim Juridik:* Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesën në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (Njëzetekatër ) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP .